



REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SER. OF KOSOVO

Planuar / Drejtuar Punimet/Planned Received/Date	02-02-2023	viti Year	2023
Organ / Shërbimi Organ / Service	1280/2023	Sasia Quantity	115



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1124/2022

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1124/2022 të datës 20.12.2022 të parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit/ Administratës Tatimore të Kosovës, në çështjen juridike "Masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 02.02.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1224/2022 e datës 20.12.2022, e parashtruar nga ankuesi

I. Mbetet ne fuqi Masa Disiplinore "Vërejtje" me numër reference: Rasti.Nr.12/22DSP e nxjerrë nga Udhëheqësi i Ekipit, Prishtinë-PR1 me datë 25.11.2022.

A r s y e t i m

Ankuesi, i cili sipas shkresave të lëndës është i punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës, me datë 20.12.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 8228/2022 të regjistruar me shenjen A.nr.1124/2022 në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vërejtjes me shkrim me numër reference: Rasti.Nr.12/22DSP të datës 25.11.2022 të nxjerrë nga Udhëheqësi i Ekipit, Prishtinë-PR1, lidhur me shqiptimin e masës disiplinore "Vërejtje".

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë me rastin e shqiptimit të masës disiplinore "Vërejtje" ka bërë konstatim të gabuar të gjendjes

faktike si dhe shkelje esenciale procedurale duke ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të legjislacionit për shërbimin civil, dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe dispozitat e ligjit të veçantë për Administratën Tatimore të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit të Administratës Tatimore të Kosovës, ndërsa me datë 18.01.2023 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova:* Ankesën me shenjen A.nr.11243/2022 me numër të protokollit 8228/2022 të parashtruar nga ankuesi me datën 20.12.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërejtjen me shkrim me numër reference: Rasti.Nr.12/22DSP të datës 25.11.2022 të nxjerrë nga Udhëheqësi i Ekipit, Prishtinë-PR1; Kërkesën për implementimin e rekomandimeve të dhëna nga Divizioni për Standarde Profesionale i datës 14.11.2022; E-mailin e datës 15.07.2022 dërguar nga [ ] me korrespondencën e bashkangjitur prej 2 faqesh; Shkresën "Web Tim & Space e datës 29.09.2022; Urdhëresën e datës 15.07.2022; Formën për vizitë përmbaruese e datës 15.07.2022; Kopjen e letërnjoftimit për [ ] Kopjen e lejes së vozitjes [ ], kërkesën e datës 15.07.2022; E-mailin e ankuesit dërguar për [ ], Shkresën e datës 11.01.2019 me referencë:03/DSP-2019; E-mailin e datës 14.2019 dërguar nga [ ] për mail\_atk me korrespondencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 25.11.2022 dërguar nga [ ] për ankuesin; E-mailin e datës 02.12.2022 dërguar nga ankuesi për [ ] me korrespondencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 29.09.2022 dërguar nga [ ] për I.L; Shkresën "forma tabelare me shifër :810863474; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 30.12.2022; Përgjigjen në kërkesë e datës 18.01.2023; Akt emërimit të ankuesit të datës 27.12.2022; Vendimin e DMZP-së i datës 20.12.2022; Formularin për përshkrimin e detyrave të punës së ankuesit; Akt emërimit të ankuesit të datës 12.05.2014; Formularin për përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Inspektor i Kontrollit; Formularin për përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Inspektor Tatimor; Deklaratën e datës 19.07.2022 me numër:418; Raportin e Divizionit për Standarde Profesionale të ATK-së i datës 11.11.2022; Vendimin e Divizionit të Ankesave të ATK-së i datës 23.08.2022; Kërkesën e datës 14.11.2022; E-mailin e datës 27.07.2022 dërguar nga [ ] për Foton e veturës zyrtare: 3Z-129-06; Shkresën "Gjobë:13362"; E-mailin e datës 13.10.2022 dërguar nga [ ] për [ ] E-mailin e datës 15.07.2022 dërguar nga [ ] për [ ] E-mailin e datës 25.11.2022;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit [ ] është e pabazuar sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, gjegjësisht akt emërimit të ankuesit i datës 27.12.2022 me shifër [ ] Nr.245/2022, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se ankuesi është i punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës në pozitën e punës "Inspektor i lartë tatimor", ndërsa udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë përmes shkresës me numër [ ] me numër reference: Rasti.Nr.12/22DSP me datë 25.11.2022 i ka shqiptuar ankuesit masën disiplinore "Vërejtjes me shkrim" për shkak të shkeljeve të lehta të detyrave të punës të përcaktuara me nenin 46 paragrafi 1 nën paragrafi 2.2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, shkelje të cilat i ka konstatuar Divizioni për Standarde Profesionale në Administratën Tatimore të Kosovës

përmes raportit të datës 14.11.2022, duke kërkuar inicimin e procedurës disiplinore apo shqiptimin e masës ndaj ankuesit.

Kolegji i Këshillit, me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit ka analizuar përmbajtjen e raportit të datës 11.12.2022 të Divizioni për Standarde Profesionale në Administratën Tatimore të Kosovës dhe ka gjetur se ankuesi me datë 15.07.2022 ka përgatitur raportin për t'i shqiptuar gjobë në vlerë prej një mijë (1,000€) euro Ndërmarrjes Publike Lokale "Prishtina Parking" me arsyetim se pas kontrollës së bërë, kishte hasur në punëtor të paregjistruar në këtë ndërmarrje, mirëpo kontrollja ishte hapur aty për aty apo ishte realizuar pasi që ankuesit për shkak të parkimit të veturës me targa 3Z-129-06 në parkingun e rrugës Vicianum në lagjen Arbëria, i cili menaxhohet nga "Prishtina Parking" dhe për këtë veprim ankuesi ishte dënuar me gjobë në vlerë prej 20 euro për shkak të mos pagesës së parkingut. Tutje Ndërmarrja Publike Lokale "Prishtina Parking" me datë 15.08.2022 ka parashtruar ankesë në Divizionin e Ankesave pranë Administratës Tatimore të Kosovës, ndërsa kjo e fundit me datë 23.08.2022 ka nxjerrë Vendimin me numër protokoli: 363/2022 përmes të cilit e ka aprovuar ankesën e Ndërmarrjes Publike Lokale "Prishtina Parking" duke e anuluar vendimin Nr.1449/2022 të datës 20.07.2022 për shqiptimin e gjobës në vlerë prej njëmijë (1,000) €uro me arsyetimin se te gjeturat mbi bazën e të cilave ankuesi kishte përgatitur raportin e datës 15.07.2022 për shqiptimin e gjobës ndaj Ndërmarrjes Publike Lokale "Prishtina Parking", janë të paqëndrueshme ngase nuk kishte të bëjë me punëtor të paregjistruar të kësaj ndërmarrje, mirëpo punëtori i identifikuar si i tillë ishte i punësuar në Kompaninë Merimanga me të cilën Ndërmarrja "Prishtina Parking" kishte kontratat për kryerjen e shërbimeve sikurse ajo e vendosjes së bllokuesve të rrotave të veturave në rastet mos pagesës së parkingut në zonat të cilat menaxhohen nga kjo ndërmarrje.

Kolegji për Shqyrtimi dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe ligjit material me rastin shqiptimit të masës disiplinore "Vërejtje" të datës 25.11.2022, ka analizuar dispozitat e nenit 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/1 - 114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: "1. Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1. Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë", si nenit 8 paragrafi 1 dhe 2 Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, ku përcaktohet se: "1. Ndaj nëpunësve civil, zbatohen masat e përcaktuara në nenin 47 të Ligjit. 2. Masa disiplinore e përcaktuar në nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i Ligjit jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i nëpunësit civil, nëse nëpunësi ka bërë shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 46 paragrafi 4 nën paragrafi 4.1, 4.2, 4.3 dhe 4.4 të Ligjit", si dhe nenin 6 paragrafi 1 dhe 4 nën paragrafët 4.1, 4.2, dhe 4.3 ku përcaktohet se: "Nëpunësit civil të institucionit, kur kanë dijeni apo dyshojnë për shkelje disiplinore, të kryera nga nëpunës të tjerë të të njëjtit institucion, duhet të raportojnë atë me shkrim Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të nëpunësit civil për të cilin pretendohet se ka kryer shkeljen. Paraqitja e shkeljes disiplinore të pretenduar, sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, duhet të i plotësojë këto kushte: 4.1. Kërkesa duhet të paraqitet në pajtim me LPPA-në. 4.2. Kurdo që është e mundur të identifikojë nëpunësin civil, i cili pretendohet se ka kryer shkeljen disiplinore. 4.3. Të përcaktojë veprimin konkret, që pretendohet se përbën shkelje disiplinore dhe rrethanat e kryerjes së tij" dhe ka ardhur në përfundimin se pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara, ngase zyrtari në cilësi të Udhëheqësit nga Divizioni i

Standardeve Profesionale të Administratës Tatimore të Kosovës me datë 14.11.2022 i është drejtuar me kërkesë Udhëheqësit të Drejtpërdrejtë të ankuesit që ndaj të njëjti të merren masa disiplinore ngase sipas raportit të datës 14.11.2022 ishte konstatuar sikurse është theksuar edhe në arsyetimin e këtij vendimi se ankuesi kishte kryer shkelje disiplinore me rastin e shqiptimit të gjobës ndaj ndërmarrjes "Prishtina Parking".

Po ashtu, Kolegji i Këshillit nga shkresat e administruara të lëndës ka konstatuar se në datën e 15.07.2022, ankuesi ka qenë i angazhuar me detyra të punës së terrenit, gjegjësisht në vizitë zyrtare tek biznesi Star Hill në lagjen Veterrnik sipas shpërndarjes së detyrave nga udhëheqësja e ekipit, ndërsa nuk ka pasur asnjë vizitë të përcaktuar zyrtare për ndonjë biznes në lagjen Arbëri ku ankuesit i ishte shqiptuar gjobë për mos pagesë të parkingut nga ana e ndërmarrjes "Prishtina Parking", andaj mbi këtë bazë shqiptimi i masës disiplinore "Vërejtje me shkrim" me numër reference: Rasti.Nr.12/22DSP ndaj ankuesit me datë 25.11.2022 e nxjerrë nga Udhëheqësi i Ekipit, Prishtinë-PR1 është vepruar në pajtueshmëri me nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-144 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: "Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë" pasi që ankuesi ka kryer shkelje të lehta disiplinore të përcaktuara me nenin 46 paragrafi 2 në paragrafi 2.2 si dhe nenit 46 paragrafi 4 nën paragrafi 4.2 i të njëjtit ligj, pasi që ankuesi e ka shfrytëzuar pozitën e tij zyrtare të Inspektorit Tatimor që të paraqes raport për shqiptimin e gjobës ndaj ndërmarrjes "Prishtina Parking" pasi që kjo e fundit e kishte gjobitur ankuesin për parkim të paautorizuar apo mos pagesë të parkingut lidhur shfrytëzimin e hapësirës e cila menaxhohet nga Ndërmarrjes Publike Lokal "Prishtina Parking" në lagjen Arbëria.

Kolegji i Këshillit, pas analizimit dhe shqyrtimit provave të lëndës, si dhe konstatimeve të dhëna në arsyetimin e këtij vendimi ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pabazuar dhe e njëjta është refuzuar sikurse në dispozitiv të këtij vendimi, ndërsa masa e shqiptuar disiplinore "Vërejtje me shkrim" me numër reference: Rasti.Nr.12/22DSP e nxjerrë nga Udhëheqësi i Ekipit, Prishtinë-PR1 me datë 25.11.2022 është lënë në fuqi ngase është konstatuar se e njëjta është shqiptuar nga zyrtari kompetentë si dhe masa e shqiptuar disiplinore "vërejtje" është masa më e lehtë disiplinore që mund të shqiptohet ndaj nëpunësve civil, kurse veprimet e ankuesit kanë përmbushur veprimet e elementeve të përgjegjesisë disiplinore të përcaktuara me nenin 45 të Ligjit Nr.06/L-144 për Zyrtarët Publik, sikurse masa e shqiptuar përmban këshillin juridike dhe arsyetimin e mjaftueshëm siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda, A.nr.1224 /2022

Flakron GASHI



Procesmbajtës

Eshref SHABANI



**Vendimi i dërgohet:**

- ▷ Ankuesit
- ▷ Drejtorit të Përgjithshëm në Administratën Tatimore të Kosovës;
- ▷ Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës; dhe
- ▷ Arkivit të KPMSHCK-së

